



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

**Njoftim Për Shtyp**

**Rasti: Rasti i përfimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë**

**Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar nga AK, shkresa me Nr.576 Prot., datë 11.10.2018 “Njoftim”, ku pala blerëse shoqëria Besniku SHPK, ka njoftuar në lidhje me transaksionin që do të rezultojë nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK.

Palët në marrëveshje janë:

*Pala Blerëse:* Besniku SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datë 15.03.1999, me NUIS J88511201I i përfaqësuar nga ortaku i vetëm Z.Dervish Domi, me objekt të aktivitetit tregtim mallrash e produkteve bujqësore e blegtorale me shumicë dhe pakicë, import-eksport i tyre; prodhim, stampim e fabrikim i miellrave të llojeve të ndryshme, tregtim me shumicë dhe pakicë i tyre, grumbullim e përpunim bimësh bujqësore e medicinale, etj.

*Pala Shitëse:* Atlas Mills SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datë 03.04.2018, me NUIS L81603036I, me objekt të aktivitetit kryesisht në përpunimin, prodhimin, paketimin dhe tregtimin e miellit, operimin në biznese industriale dhe tregtare që kanë lidhje me industrinë e miellit, marketingun e grurit dhe prodhimet e tjera bujqësore, etj.

Më datë 28 Shtator 2018, palët pjesëmarrëse në transaksion kanë lidhur marrëveshje “Kontratë Shitje Kuotash”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**